



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 244

Tiranë – E martë, 20 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 16.12.2016	Për disa ndryshime në ligjin nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar..... 24539
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 14.12.2016	Për monitorimin shkencor pasvaksinal të kafshëve të vaksinuara në kuadër të Projektit PAZA..... 24545
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 884, datë 16.12.2016	Për shpërblimin dhe kompensimin e disa kategorive të veçanta për festat e fundvitit, 2016..... 24547
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 885, datë 16.12.2016	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit, 2016..... 24547
Urdhër i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 398, datë 30.11.2016	Për një ndryshim në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar..... 24548
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 72, datë 7.12.2016	Me objekt: Konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli..... 24553
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 181, datë 23.11.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004 dhe nr. 146, datë 24.12.2013”..... 24561
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 182, datë 23.11.2016	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal..... 24562

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 183, datë 23.11.2016	Mbi miratimin e kërkesës për lënien peng të aseteve të shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a.....	24563
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 184, datë 23.11.2016	Mbi miratimin e kërkesës për lënien peng të aseteve të shoqërisë “Energial” sh.p.k., në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a..	24564
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 185, datë 23.11.2016	Mbi kërkesën e TAP AG për aprovimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” të rishikuar, paraqitur në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar /Final Joint Opinion, miratuar me vendimin nr. 12, datë 14.2.2014.....	24565
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 186, datë 23.11.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Spatharë”, me fuqi të instaluar 1038 kw.....	24566
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 23.11.2016	Mbi kërkesën e shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	24567
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetases Valbona Azem Harizaj.....	24568



AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 16.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.147/2015, “PËR BUXHETIN E VITIT
2016”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2016 është:

Të ardhurat	51 449 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- Transferata e pakushtëzuar nga buxheti qendror	13 045 milionë lekë;
- Transferata specifike	11 033 milionë lekë;
- Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	10 000 milionë lekë;
Të ardhura të tjera	17 371 milionë lekë;
Shpenzimet	51 449 milionë lekë.”.

Neni 2

Neni 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2016 është:

I. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror	
Të ardhurat, gjithsej	110 684 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	66 093 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	40 320 milionë lekë;
- transferata për rritjen e pensione nga buxheti	635 milionë lekë;
- transfertë për shpërblimin e pensionistëve	3 636 milionë lekë;
Shpenzimet	110 684 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të

personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2016, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensione.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 165 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	778 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 238 milionë lekë;
- fondi për rritjen e pensione	35 milionë lekë;
- transfertë për shpërblimin e pensionistëve	114 milionë lekë;
Shpenzimet	5 165 milionë lekë.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 262 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.”.

Neni 3

Neni 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2016 është:

Të ardhurat, gjithsej	35 794 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	10 630 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	25 164 milionë lekë;
Shpenzimet	35 794 milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 10 ndryshohen shumat, si më poshtë vijon dhe shtohet një paragraf:

Shpenzime të buxhetit qendror bëhet	349 522 milionë lekë;
Huadhënie për energjinë bëhet	3 300 milionë lekë.

“Ministria e Financave, në përputhje me përdorimin e fondeve buxhetore, transferon në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, nga fondet e papërdorura buxhetore, deri në 4 000 milionë lekë. Këto fonde përdoren me vendime të Këshillit të Ministrave, për shpronësime në proces apo shpronësime të reja.”.



Neni 5

Paragrafi i pestë, i nenit 15, riformulohet, si më poshtë vijon:

“Këshilli i Ministrave detajon sipas bashkive fondin për investime për funksionin e ujitjes dhe kullimit dhe funksionin e rrugëve rurale, parashikuar në tabelën 3, bashkëlidhur këtij ligji. Shpërndarja e këtij fondi reflektohet në transfertën specifike në tabelën 3 të këtij ligji.

Transferta specifike sipas funksioneve, e papërdorur gjatë vitit buxhetor, trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës.”

Neni 6

Neni 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 18

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2016, është 36 730 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë:

Për huamarrjen e brendshme vjetore deri në 16 997 milionë lekë.

- Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja deri në -4967 milionë lekë.

- Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 3 600 milionë lekë.

- Për mbështetjen e huaj buxhetore nga institucionet ndërkombëtare dhe nga burime të tjera deri në 21 100 milionë lekë.

- Stoku i borxhit shtetëror (pa përfshirjen e detyrimeve të prapambetura) vlerësohet të arrijë në 1 089 502 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit shtetëror vlerësohet të arrijë në 1 029 372 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të garantuar vlerësohet të arrijë në 60 130 milionë lekë.”

Neni 7

Tabela 1 dhe tabela 3 për bashkitë, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohen përkatësisht me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ.

Neni 8

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Akti normativ II 2016 (dhjetor) - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE
(në 000/LEKË)

Kodi	Emërtimi i institucionit / Programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	Presidenca	196,770	5,224	0	5,224	201,994
01120	Veprimtaria e Presidentit	196,770	5,224	0	5,224	201,994
2	Kuvendi	1,025,700	37,858	0	37,858	1,063,558
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	383,700	37,858	0	37,858	421,558
01120	Veprimtaria ligjvënëse	642,000	0	0	0	642,000
3	Kryeministria	1,645,421	853,297	292,466	1,145,763	2,791,184
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	469,900	226,264	152,466	378,730	848,630
01140	e-Qeverisja	981,136	552,944	0	552,944	1,534,080
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	194,385	74,089	140,000	214,089	408,474
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	986,750	554,238	421,000	975,238	1,961,988
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	339,150	99,000	281,000	380,000	719,150
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	228,700	167,086	140,000	307,086	535,786
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	279,000	50,176	0	50,176	329,176
04760	Zhvillimi i turizmit	139,900	237,976	0	237,976	377,876
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	5,080,700	2,787,612	3,143,474	5,931,086	11,011,786
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	240,700	0	0	0	240,700
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,864,450	226,996	259,374	486,370	2,350,820
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	539,900	2,318,606	1,447,000	3,765,606	4,305,506
04250	Zhvillimi rural duke mbësht. prodh. bujq. blek, agroind dhe market.	2,039,750	145,590	1,142,750	1,288,340	3,328,090
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	200,200	0	0	0	200,200



05470	Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	25,000	0	0	0	25,000
04230	Mbështetje për peshkimin	86,000	77,420	200,000	277,420	363,420
05640	Administrimi i ujërave	84,700	19,000	94,350	113,350	198,050
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	3,287,050	14,437,707	11,951,856	26,389,563	29,676,613
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	356,000	8,000	60,000	68,000	424,000
04520	Transporti rrugor	1,931,960	9,040,869	4,716,731	13,757,600	15,689,560
04530	Mbështetje për studime në transport	18,530	1,000	2,000	3,000	21,530
04540	Transporti detar	75,700	393,317	500,000	893,317	969,017
04550	Transporti hekurudhor	407,250	110,000	0	110,000	517,250
04560	Transporti ajror	18,910	2,500	0	2,500	21,410
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	478,700	4,782,021	6,464,125	11,246,146	11,724,846
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	100,000	209,000	309,000	309,000
10	Ministria e Financave	6,977,621	345,240	580,323	925,563	7,903,184
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	836,200	131,336	208,000	339,336	1,175,536
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	433,750	2,427	0	2,427	436,177
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	402,068	0	0	0	402,068
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,202,730	54,193	0	54,193	2,256,923
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,034,373	153,284	372,323	525,607	3,559,980
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	68,500	4,000	0	4,000	72,500
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	32,205,810	2,799,500	350,000	3,149,500	35,355,310
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	645,000	129,500	0	129,500	774,500
09120	Arsimi baze (përfshirë parashkollorin)	19,123,400	1,219,000	0	1,219,000	20,342,400
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	5,802,609	748,000	140,000	888,000	6,690,609
09450	Arsimi universitar	6,068,000	301,000	147,000	448,000	6,516,000
09770	Fonde për shkencën	290,800	0	63,000	63,000	353,800
08140	Zhvillimi i sportit	276,001	402,000	0	402,000	678,001
12	Ministria e Kulturës	1,297,599	389,694	83,000	472,694	1,770,293
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	119,566	10,000	0	10,000	129,566
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	412,859	112,121	68,000	180,121	592,980
08230	Arti dhe kultura	765,174	267,573	15,000	282,573	1,047,747
13	Ministria e Shëndetësisë	29,349,100	1,568,869	378,730	1,947,599	31,296,699
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	304,600	3,000	0	3,000	307,600
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	8,093,700	112,510	76,100	188,610	8,282,310
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	18,353,120	1,236,817	302,630	1,539,447	19,892,567
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,554,680	57,042	0	57,042	2,611,722
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	43,000	159,500	0	159,500	202,500
14	Ministria e Drejtësisë	7,184,700	873,313	233,000	1,106,313	8,291,013
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	402,400	51,240	0	51,240	453,640
01120	Publikimet zyrtare	49,200	200	0	200	49,400
01130	Mjekësia ligjore	54,500	71,873	0	71,873	126,373
03440	Sistemi i burgjeve	4,287,250	720,878	233,000	953,878	5,241,128
03350	Shërbimi i përmbartimit gjyqësor	98,350	2,200	0	2,200	100,550
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	12,500	200	0	200	12,700
01180	Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave	2,162,500	6,522	0	6,522	2,169,022
03490	Shërbimi i provës	118,000	20,200	0	20,200	138,200
15	Ministria e Punëve të Jashtme	2,245,000	244,851	0	244,851	2,489,851
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	118,500	191,851	0	191,851	310,351
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	1,928,000	53,000	0	53,000	1,981,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	198,500	0	0	0	198,500
16	Ministria e Brendshme	17,848,230	1,559,787	386,000	1,945,787	19,794,017
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	919,308	274,854	0	274,854	1,194,162
03140	Policia e Shtetit	13,457,600	767,587	300,000	1,067,587	14,525,187
03150	Garda e Republikës	1,271,754	68,000	0	68,000	1,339,754
01160	Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor	505,280	0	81,000	81,000	586,280



01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	1,004,470	439,346	0	439,346	1,443,816
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	94,838	10,000	0	10,000	104,838
10910	Emergjencat civile	594,980	0	5,000	5,000	599,980
17	Ministria e Mbrojtjes	10,889,975	1,628,582	0	1,628,582	12,518,557
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	903,700	30,000	0	30,000	933,700
02120	Forcat e lufimit	4,518,600	1,416,482	0	1,416,482	5,935,082
09430	Arsimi ushtarak	472,500	15,000	0	15,000	487,500
02150	Mbështetja e lufimit	4,256,396	167,100	0	167,100	4,423,496
07340	Mbështetje për shëndetësinë	738,779	0	0	0	738,779
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,363,000	45,000	0	45,000	1,408,000
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,363,000	45,000	0	45,000	1,408,000
19	Drejtoria e Radio Televizionit	505,000	0	0	0	505,000
08310	Shërbimet për shqiptaret jashtë kufirit	245,000	0	0	0	245,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	150,000	0	0	0	150,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	53,000	0	0	0	53,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe Kinematografisë	57,000	0	0	0	57,000
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	157,000	5,000	0	5,000	162,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	157,000	5,000	0	5,000	162,000
22	Akademia e Shkencës	91,550	2,000	2,000	4,000	95,550
01520	Veprimtaria akademike	91,550	2,000	2,000	4,000	95,550
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	348,150	13,300	135,000	148,300	496,450
01120	Veprimtaria audituese e KLSH-së	348,150	13,300	135,000	148,300	496,450
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinise	74,653,000	975,213	47,000	1,022,213	75,675,213
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	134,250	30,000	0	30,000	164,250
10220	Sigurimi shoqëror	48,980,150	0	0	0	48,980,150
10430	Perkujdesi social	19,895,500	259,300	40,000	299,300	20,194,800
10550	Tregu i punës	1,890,371	118,000	0	118,000	2,008,371
04170	Inspektimi në punë	170,140	8,639	0	8,639	178,779
10460	Përfshirja sociale	74,051	5,251	5,000	10,251	84,302
08480	Mbështetje për kultet fetare	120,700	400	0	400	121,100
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	2,027,600	4,589	0	4,589	2,032,189
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,360,238	549,034	2,000	551,034	1,911,272
26	Ministria e Mjedisit	888,300	2,283,144	341,700	2,624,844	3,513,144
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	143,800	25,000	0	25,000	168,800
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	392,100	2,032,392	207,700	2,240,092	2,632,192
04260	Administrimi i pyjeve	352,400	225,752	134,000	359,752	712,152
28	Prokuroria e Përgjithshme	1,475,625	230,000	0	230,000	1,705,625
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,475,625	230,000	0	230,000	1,705,625
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqësor	1,905,080	240,000	0	240,000	2,145,080
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	26,300	660	0	660	26,960
03310	Buxheti gjyqësor	1,878,780	239,340	0	239,340	2,118,120
30	Gjykata Kushtetuese	111,830	4,000	0	4,000	115,830
03320	Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	111,830	4,000	0	4,000	115,830
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	54,200	2,720	0	2,720	56,920
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-së	54,200	2,720	0	2,720	56,920
40	Partitë politike	200,000	0	0	0	200,000
01110	Mbështetje për partitë politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbështetje për shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteraneve me status	2,000	0	0	0	2,000
50	Instituti i Statistikës	357,459	14,648	101,000	115,648	473,107
01320	Veprimtaria statistikore	357,459	14,648	101,000	115,648	473,107
55	Shkolla e Magjistraturës	60,900	7,000	0	7,000	67,900
09820	Veprimtaria arsimore	60,900	7,000	0	7,000	67,900



56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	923,800	2,466,000	3,389,800	3,389,800
06210	Programe zhvillimi	0	923,800	2,466,000	3,389,800	3,389,800
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	150,000	162	0	162	150,162
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	150,000	162	0	162	150,162
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	74,080	2,000	0	2,000	76,080
03320	Veprimtaria mbikëqyrëse e KLD-së	74,080	2,000	0	2,000	76,080
66	Avokati i Popullit	101,500	4,000	17,000	21,000	122,500
03320	Shërbimi i avokatisë	101,500	4,000	17,000	21,000	122,500
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	49,900	2,000	0	2,000	51,900
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	49,900	2,000	0	2,000	51,900
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	97,000	3,000	0	3,000	100,000
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	97,000	3,000	0	3,000	100,000
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0	0	0
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	112,550	16,000	0	16,000	128,550
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	112,550	16,000	0	16,000	128,550
77	Autoriteti i Konkurrencës	62,200	1,000	0	1,000	63,200
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	62,200	1,000	0	1,000	63,200
78	Ministria e Integritimit	170,500	47,087	125,000	172,087	342,587
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	59,100	1,000	0	1,000	60,100
01140	Drejtesia dhe tregu i brendshëm	28,700	0	0	0	28,700
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integritimit	82,700	46,087	125,000	171,087	253,787
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	9,100	500	0	500	9,600
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	9,100	500	0	500	9,600
87	Institucione të tjera qeveritare	396,113	133,595	50,000	183,595	579,708
01320	Shërbime qeveritare	90,000	39,125	0	39,125	129,125
01130	Shërbimi i prokurimit publik	78,100	1,500	0	1,500	79,600
01150	Shërbime të tjera	228,013	92,970	50,000	142,970	370,983
01510	Shërbime për teknologjinë dhe inovacionin	0	0	0	0	0
88	Mbështetje për shoqërinë civile	124,650	1,000	0	1,000	125,650
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	124,650	1,000	0	1,000	125,650
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	55,500	149,000	0	149,000	204,500
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	55,500	149,000	0	149,000	204,500
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	37,000	1,000	0	1,000	38,000
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	37,000	1,000	0	1,000	38,000
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	27,100	1,000	0	1,000	28,100
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	27,100	1,000	0	1,000	28,100
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	676,500	1,819,292	632,283	2,451,575	3,128,075
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	198,260	1,407,300	0	1,407,300	1,605,560
04320	Mbështetje për energjinë	85,500	84,765	618,283	703,048	788,548
04430	Mbështetje për burimet natyrore	151,000	303,671	14,000	317,671	468,671
04440	Mbështetje për industrinë	241,740	23,556	0	23,556	265,296
94	Ministria e Zhvillimit Urban	1,106,100	938,000	113,600	1,051,600	2,157,700
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	184,500	10,000	0	10,000	194,500
06180	Planifikimi urban dhe strehimi	921,600	928,000	113,600	1,041,600	1,963,200
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	0	0	0	0	0
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	0	0	0	0	0
TOTALI		205,641,313	35,950,233	21,850,432	57,800,665	263,441,978



Tab.3

TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE SPECIFIKE PËR BASHKITË PËR VITIN 2016

Në mijë lekë

NR.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzu ar 2016	Transferta specifike për financimin e funksioneve									Totali
			Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor	Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujitja dhe kullimi	Fond për investime	
1	Bashkia Belsh	91,156	0	21,364	1,034	0	0	613	7,523	2,198	0	123,889
2	Bashkia Berat	219,580	26,369	119,947	7,088	26,565	22,416	2,453	4,636	6,459	0	435,512
3	Bashkia Bulqizë	196,658	0	49,337	242	8,269	0	2,453	27,453	5,227	0	289,638
4	Bashkia Cërrik	105,932	4,426	38,592	3,903	0	0	613	1,728	5,843	0	161,037
5	Bashkia Delvinë	47,256	0	20,583	1,493	6,804	0	613	3,241	2,198	0	82,188
6	Bashkia Devoll	139,873	0	48,225	2,093	3,435	0	1,840	9,981	3,430	0	208,876
7	Bashkia Dibër	314,948	23,186	117,966	5,685	19,043	0	2,453	13,457	5,843	0	502,580
8	Bashkia Divjakë	154,086	0	35,277	1,102	0	0	613	7,452	13,184	0	211,715
9	Bashkia Dropull	56,698	0	2,162	939	0	0	613	4,824	5,227	0	70,464
10	Bashkia Durrës	573,031	21,900	156,596	15,624	39,466	0	1,226	23,000	26,497	0	857,341
11	Bashkia Elbasan	489,941	27,401	219,166	27,537	27,487	19,938	3,066	16,743	6,459	0	837,738
12	Bashkia Fier	419,583	20,492	171,844	9,199	29,727	0	2,453	8,163	19,345	0	680,807
13	Bashkia Finiq	96,194	0	7,678	38	0	0	613	2,689	7,075	10,000	124,287
14	Bashkia Fushë-Arrëz	66,272	0	23,876	3,831	0	0	3,679	12,866	2,198	0	112,722
15	Bashkia Gjirokastrë	147,446	17,406	82,720	5,048	25,327	0	2,453	7,341	8,255	0	295,997
16	Bashkia Gramsh	160,347	6,218	66,153	3,110	8,110	0	2,453	18,613	2,198	0	267,202
17	Bashkia Has	108,340	6,481	25,892	2,448	8,962	0	3,066	1,527	2,198	0	158,914
18	Bashkia Himarë	83,211	0	11,278	520	6,804	0	1,226	4,275	2,198	0	109,512
19	Bashkia Kamzë	374,451	0	94,804	8,357	0	0	0	0	2,814	0	480,426
20	Bashkia Kavajë	154,254	12,254	67,244	4,044	12,471	0	613	5,367	10,720	0	266,968
21	Bashkia Këlcyrë	48,236	0	7,903	2,360	0	0	613	7,341	2,198	10,000	78,652
22	Bashkia Klos	105,643	0	23,217	1,506	0	0	2,453	9,638	2,198	0	144,654
23	Bashkia Kolonjë	94,563	9,360	30,420	3,399	7,495	0	3,066	8,549	2,814	0	159,665
24	Bashkia Konispol	46,691	0	6,236	31	0	0	613	1,655	2,814	0	58,040
25	Bashkia Korçë	324,808	21,078	166,470	15,672	25,356	0	3,066	6,267	19,961	0	582,679
26	Bashkia Krujë	219,207	0	50,448	3,034	12,056	0	3,066	6,810	7,691	0	302,313
27	Bashkia Kuçovë	118,950	0	61,461	4,943	11,249	2,478	613	1,928	5,227	0	206,848
28	Bashkia Kukës	249,566	18,723	85,297	4,132	41,137	2,360	3,066	18,402	5,227	0	427,909
29	Bashkia Kurbin	183,100	0	73,197	9,644	7,851	0	613	3,707	11,336	0	289,448
30	Bashkia Lezhë	230,553	8,958	97,356	8,834	25,735	0	3,066	4,957	13,184	0	392,643
31	Bashkia Libohovë	35,241	0	4,075	949	0	0	613	6,083	2,198	0	49,159
32	Bashkia Librazhd	169,887	0	67,345	2,652	8,110	0	3,066	23,069	5,227	0	279,356
33	Bashkia Lushnjë	284,765	8,910	136,905	9,493	11,622	0	1,226	7,020	21,193	0	481,135
34	Bashkia Malësi e Madhe	184,092	4,053	41,021	4,379	8,027	0	3,679	12,367	4,046	0	261,666
35	Bashkia Maliq	204,938	0	51,105	6,286	0	0	1,226	8,308	15,084	0	286,948
36	Bashkia Mallakastër	122,350	0	58,398	4,939	8,764	0	613	6,860	5,227	0	207,151
37	Bashkia Mat	142,129	12,141	62,902	4,950	8,269	0	2,453	24,082	2,198	0	259,124
38	Bashkia Memaliaj	82,220	0	30,667	6,186	0	0	613	4,195	2,198	0	126,079
39	Bashkia Mirditë	152,289	21,078	52,611	6,294	7,851	0	3,066	17,936	5,227	0	266,352
40	Bashkia Patos	95,542	0	39,210	2,978	8,764	0	0	1,728	2,814	0	151,036
41	Bashkia Peqin	96,790	0	32,355	1,088	3,709	0	613	4,122	2,198	30,000	170,875
42	Bashkia Përmet	85,976	6,323	22,024	2,429	7,729	0	2,453	6,502	2,198	0	135,635
43	Bashkia Pogradec	261,066	0	108,199	7,959	10,742	0	2,453	19,512	2,814	0	412,746
44	Bashkia Poličan	72,694	0	26,571	3,381	3,591	0	1,226	3,267	2,198	0	112,929
45	Bashkia Përrenjas	117,256	0	29,720	2,466	0	0	2,453	17,581	2,198	0	171,674
46	Bashkia Pukë	82,123	13,174	31,288	5,724	11,512	0	3,679	6,159	2,198	0	155,857
47	Bashkia Pustec	25,369	0	5,042	25	0	0	613	297	2,198	0	33,544
48	Bashkia Roskovec	81,882	0	18,461	1,948	0	0	0	3,775	5,843	0	111,909
49	Bashkia Rrogozhinë	99,535	0	26,099	1,985	0	0	613	0	2,198	0	130,430
50	Bashkia Sarandë	95,102	17,697	45,437	3,121	12,676	0	1,840	0	5,227	0	181,100
51	Bashkia Selenicë	129,843	0	18,915	4,271	0	0	613	2,620	5,227	0	161,489
52	Bashkia Shijak	96,760	0	39,293	2,513	0	0	613	46	5,227	0	144,452
53	Bashkia Shkodër	490,679	55,763	145,935	20,679	30,678	18,480	3,679	17,857	11,388	0	795,138
54	Bashkia Skrapar	104,520	10,673	39,457	3,907	7,846	0	1,226	12,054	2,198	0	181,881
55	Bashkia Tepelenë	62,243	6,481	34,228	2,954	7,729	0	613	5,873	2,198	0	122,321
56	Bashkia Tiranë	1,531,459	86,601	594,075	72,918	98,019	0	3,679	18,864	5,843	0	2,411,458
57	Bashkia Tropojë	150,080	0	43,307	2,998	8,962	0	3,066	8,309	2,198	0	218,921
58	Bashkia Ura Vajgurore	91,895	0	28,094	602	0	0	613	3,591	3,430	0	128,226
59	Bashkia Vau i Dejës	154,016	8,400	22,532	1,966	0	0	1,840	5,440	4,046	0	198,041
60	Bashkia Vlorë	383,793	24,822	163,589	21,229	30,922	0	3,066	2,591	21,649	0	651,661
61	Bashkia Vorë	86,140	0	32,149	2,015	0	0	613	466	2,198	0	123,581
Fondi për Zhvillimin e Rajoneve		10,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10,000,000
Fond për investime		0	0	0	0	0	0	0	2,000,000	3,450,000	0	5,450,000
Totali		21,393,247	500,369	4,033,518	372,174	648,874	65,671	105,468	2,500,713	3,822,500	50,000	33,492,533



VENDIM
Nr. 883, datë 14.12.2016
PËR MONITORIMIN SHKENCOR
PASVAKSINAL TË KAFSHËVE TË
VAKSINUARA NË KUADËR TË
PROJEKTIT PAZA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 61/2016, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e gjuetisë së dhelprës së kuqe, për arsye të monitorimit shkencor pasvaksinal, që realizohet në kuadër të projektit “Përmirësimi i mbrojtjes së konsumatorit ndaj sëmundjeve zoonotike (PAZA)”.

2. Gjuetia e dhelprës së kuqe të kryhet nëpërmjet marrjes së kampionëve të dhelprës së kuqe në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura, në ditët e enjte, të premte dhe të shtunë, gjatë periudhës 9 dhjetor 2016 deri më 9 janar 2017.

3. Për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe nëpërmjet gjuajtjes së tyre të angazhohen në të gjithë vendin 198 gjuetarë që do të sigurojnë në total 324 kampionë të dhelprave. Numri i personave, që do të realizojnë gjuetinë dhe numri i individëve/kampionëve të dhelprave që do të sigurohen, për secilin qark, jepen në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ministri i Mjedisit pajis, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, gjuetarët në çdo qark me autorizimin përkatës për marrjen e kampionëve të dhelprës së kuqe.

5. Gjatë të gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku do të kryhet kampionimi i dhelprave do të jetë i pranishëm personeli i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në Qarqe, ndërkohë që Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve do të inspektojë procesin në vazhdimësi.

6. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkërendojë punën për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve si dhe raportimin për përfundimin e fazës së gjashtë të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PËR PËRJASHTIMIN NGA FUSHA E VEPRIMIT TË LIGJIT Nr. 61/2016 “PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUE TISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

(FAZA 6)

LISTA E GJUE T ARËVE PËR SIGURIMIN E KAMPIONËVE LABORATORIKE,
 NUMRI I KAMPIONËVE TË DHELPRAVE TË KUQE

Nr.	Qarku	Bashkia	Nr. i gjuetarëve		Nr. i kampionëve të dhelprave	
			Qark	Bashki	Qark	Bashki
1	BERAT		12		21	
		Berat		7		14
		Kuçovë		1		2
		Skrapar		3		3
		Ura Vajgurore		1		2
2	DIBËR		13		24	
		Dibër		6		10
		Bulqizë		4		7
		Mat		2		4
		Klos		1		3
3	DURRËS		15		10	
		Durrës		6		3
		Shijak		2		3



		Krujë		7		4
4	ELBASAN		22		37	
		Elbasan		6		8
		Belsh		2		4
		Cërrik		2		4
		Librazhd		3		5
		Përrenjas		2		4
		Peqin		3		4
		Gramsh		4		8
5	FIER		18		24	
		Fier		5		6
		Lushnjë		4		6
		Divjakë		2		3
		Roskovec		1		2
		Mallakastër		6		7
6	GJIROKASTËR		14		38	
		Gjirokastër		4		14
		Libohovë		2		5
		Tepelenë		2		6
		Memaliaj		2		4
		Përmet		3		7
		Këlcyrë		1		2
7	KORÇË		24		53	
		Korçë		6		14
		Maliq		2		5
		Devoll		3		4
		Pustec		2		3
		Kolonjë		6		14
		Pogradec		5		13
8	KUKËS		12		20	
		Kukës		5		8
		Tropojë		6		11
		Has		1		1
9	LEZHË		18		12	
		Lezhë		10		3
		Kurbini		2		3
		Mirditë		6		6
10	SHKODËR		17		36	
		Shkodër		5		12
		Vau i Dejës		2		4
		Malësi e Madhe		5		14
		Pukë		3		4
		Fushë-Arrëz		2		2
11	TIRANË		19		13	
		Tiranë		13		4
		Vorë		2		2
		Kamzë		1		2
		Kavajë		2		3
		Rrogozhinë		1		2
12	VLORË		14		36	
		Vlorë		6		20
		Sarandë		1		2
		Konispol		1		2
		Finiq		2		4
		Delvinë		2		4
		Himarë		1		2
		Selenicë		1		2
	TOTALI		198		324	



VENDIM

Nr. 884, datë 16.12.2016

**PËR SHPËRBLIMIN DHE
KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE
TË VEÇANTA PËR FESTAT E
FUNDVITIT, 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë kompensohen financiarisht, për vitin 2016, në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;

c) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;

ç) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare prej 439 000 000 (katërqind e tridhjetë e nëntë milionë) lekësh, përballohen nga buxheti i vitit 2016, zëri “Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë”, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 885, datë 16.12.2016

**PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE
PËR FESTAT E FUNDVITIT, 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë, të personave, për vitin 2016, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) Personat që marrin pension sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Personat që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



d) Personat që marrin pension pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANC-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm, për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogaritura në shumën 3 754 800 000 (tre miliardë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër milionë e tetëqind mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i sigurimeve shoqërore, i miratuar për vitin 2016.

Shpërblimet të kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2016 dhe të paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2016, ato paguhen edhe gjatë vitit të ardhshëm.

3. Procedura e pagesës dhe e administrimit të shpërblimit për pensionistët të realizohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe “Posta Shqiptare” sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe “Posta Shqiptare” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 398, datë 30.11.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 83, DATË 10.2.2012, “PËR
RREGULLAT DHE PROCEDURAT E
SHITJES SË PRODUKTEVE
HIDROKARBURE (NAFTË BRUTO)”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 1 të aktit normativ nr. 2, datë 18.6.2010, “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993,

Faqe | 24548

“Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10298, datë 8.7.2010; të ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”; të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedimet e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Në pikën 16/a, paragrafi i tretë riformulohet:

“Kontrata e shitjes, ndërmjet kushteve të tjera, duhet të përfshijë detyrimisht, të gjitha kërkesat e përcaktuara në kontratat tip për shitjen e naftës bruto dhe gazit natyror. Këto kontrata i bashkëlidhen këtij urdhri dhe botohen në Fletoren Zyrtare.”.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a. Patos, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në MEI.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjiknuri**

KONTRATË SHITBLERJE
Nr. _____, datë ___/___/___

Objekti i kontratës
Shitje e produktit hidrokarbur (gaz
natyror)

Kjo kontratë është e lidhur në datën ___/___/___ midis:

Autoritetit shitës, shoqëria “Albpetrol” sh.a., me NUIS J82916500U dhe adresë: Rruga Nationale Fier-Patos, KM 7, përfaqësuar nga z. _____, në cilësinë e administratorit, që këtu e më poshtë do të quhet “Shitësi”.

Dhe
Ofertuesit **fitues** **shoqëria**
“ _____ , me adresë:



_____, me NUIS : _____, përfaqësuar në këtë kontratë nga z. _____, në cilësinë e administratorit, që këtu e më poshtë do të quhet “Blerësi”.

Secila palë siguron palën tjetër se ajo ka të drejtën, fuqinë e plotë juridike dhe autoritetin, për të hyrë në këtë kontratë shitblerjeje dhe se kjo kontratë shitblerje përbën një dokument të vlefshëm ligjor.

Prandaj sot, në datën e nënshkrimit të kontratës, Shitësi dhe Blerësi bien dakord të lidhen ligjërisht njëri me tjetrin dhe të përmbushin kërkesat, detyrimet dhe përgjegjësitë respektive në lidhje me këtë kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e mëposhtëm:

Baza ligjore

1. Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar.

2. Ligji nr.102/2015, datë 23.9.2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3. Urdhri nr. 83, datë 10.2.2012, “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure”, i ndryshuar.

4. Nenet 541–545 dhe 705–756 të Kodit Civil.

Përkufizime

“**Kontratë**” do të thotë marrëveshja e shkruar, e lidhur midis autoritetit shitës dhe ofertuesit, që përbëhet nga dokumentet e ankandit, duke përfshirë KPK-në dhe KVK-në, të gjitha bashkëngjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“**Çmim kontrate**” do të thotë çmimi që i paguhet autoritetit shitës sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.

“**Incoterms**” do të thotë termat ndërkombëtarë tregtarë që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtarë që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot dhe risqet e lidhura me transferimin e mallrave nga autoriteti shitës tek ofertuesi fitues.

“**Lëvrimiti**” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e mallrave në vendin e shpërndarjes, siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi,

kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

“**Grafik lëvrimiti**” do të thotë plani i lëvrimit të gazit natyror mbi baza vjetore, siç është rënë në dakord mes blerësit dhe shitësit.

“**Shitësi**” do të thotë autoriteti shitës, që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate, shet gaz natyror.

“**Blerësi**” do të thotë Ofertues fitues. Personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate, blen gazin natyror.

“**Palë(t)**” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“**Shërbimet në lidhje me to**” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të gazit natyror, si: transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e gazit natyror.

“**Objekt i kontratës**” do të thotë shitblerja e gazit natyror dhe shërbimet në lidhje me të që Shitësi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“**Standarde teknike**” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren, si: rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave, për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

“**TTF**” është treguesi i publikuar në Ice Index Dutch TTF Gas Futures, në datën e kryerjes së pagesës.

Neni 1

Objekti i kontratës

1.1 Objekt i kësaj kontrate është shitja e produktit hidrokarbur (gaz natyror) në sasinë e përcaktuar në grafikun e lëvrimit dhe sipas kushteve të rëna dakord midis Shitësit dhe Blerësit.

1.2 Palët bien dakord se sasia e gazit e parashikuar për t’u livruar nga Shitësi te Blerësi sipas të dhënave të parashikuara në grafikun e livrimit, përfaqëson një planifikim paraprak dhe varet nga prodhimi që Shitësi do të sigurojë nga prodhimi i vet dhe nga Kontraktorët e Marrëveshjeve Hidrokarbure.

1.3 Blerësi bie dakord se nuk do të ngrejë pretendime ndaj Shitësit nëse sasia që do të



tërheqë mund të jetë më e vogël se sasia e planifikuar në kontratë, me kusht që ulja e sasisë të lidhet ngushtësisht me uljen e sasisë se gazit të planifikuar për t'u prodhuar nga Shitësi ose të planifikuar për t'u tërhequr nga Kontraktorët e marrëveshjeve hidrokarbure.

Neni 2

Hyrja në fuqi, afati

2.1 Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit së saj nga të dyja palët (data efektive).

2.2 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë kohore ____ vjeçare, duke filluar nga data efektive. Kontrata mund të zgjidhet përpara përfundimit të këtij afati për rastet e parashikuara në nenin 10.

Neni 3

Livrimi, matja

3.1 Sasia e gazit natyror do të shitet nga Shitësi te Blerësi, në pikat e livrimit të përcaktuara si më poshtë:

1. _____
2. _____

3.2 Pavarësisht pikave të livrimit të përcaktuara në pikën 3.1 më sipër, palët gjatë kohëzgjatjes së kontratës mund të bien dakord për shitjen e gazit natyror edhe në pika të tjera.

3.3 Matja e sasisë aktuale të gazit natyror, të dorëzuar nga Shitësi te Blerësi, në përputhje me këtë kontratë do të bëhet nga pajisjet matëse të instaluar në pikën e livrimit nga ana e Shitësit.

3.4 Të gjitha pajisjet matëse të përdorura për të nxjerrë të dhëna për përlogaritjet e pagesës në përputhje me këtë kontratë, pasi të jenë testuar dhe kalibruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të vulosen dhe vulat nuk do të thyhen me përjashtim të vullnetit të përbashkët të palëve të shprehur nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës palë kur pajisjet matëse duhet të inspektohen dhe testohen ose rregullohen siç parashikohet më poshtë.

3.5 Palët do të takohen në Pikën e Livrimit në ditën kalendarike të përcaktuar për kryerjen e operacionit në përputhje me këtë kontratë dhe bashkërisht regjistrojnë leximin aktual të pajisjeve matëse. Leximi i përbashkët do të pasqyrohet në një dokument me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesit e të dyja palëve.

3.6 Nëse raportet e testimi ose kalibrimit tregojnë gabime në matje për pajisjet matëse, atëherë leximi aktual i matjeve i regjistruar gjatë periudhës së testimi apo kalibrimit do të korrigjohet, duke e ulur ose rritur, sipas rastit, në lidhje me shkallën e gabimit në matje të treguar në raportin e testimi apo kalibrimit.

Neni 4

Cilësia e gazit natyror

4.1 Çdo sasi gazi natyror që do t'i shitet Blerësit, sipas një grafiku të pranuar prej tyre, duhet të bëhet në përputhje me specifikimet e mëposhtme, në varësi të pikës së livrimit:

4.1.1 Në pikën e livrimit _____, në presionin ____ bar, temperaturë 15 (pesëmbëdhjetë) gradë celsius dhe ____ fuqi kalorifike.

4.1.2 Në pikën e livrimit _____, në presionin ____ bar, temperaturë 15 (pesëmbëdhjetë) gradë celsius dhe ____ fuqi kalorifike.

4.1.3 Gazi natyror do të dorëzohet te Blerësi i seperuar dhe pa përmbajtje lagështie.

4.2 Për çdo sasi gazi që do të shitet, do të plotësohet një faturë teknike, e cila duhet të përmbajë, ndër të tjera, edhe specifikimet e parashikuara në nenin 4.1 më sipër. Fatura teknike duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të secilës palë të ngritur për këtë qëllim.

4.3 Blerësi është i lejuar në çdo kohë të kërkojë raportet e testit të cilësisë nga Shitësi ose të bëjë marrjen e mostrave dhe të bëjë teste të pavarura për cilësinë e gazit natyror të furnizuar.

Neni 5

Çmimi, faturimi, mënyra e pagesës

5.1 Çmimi që Blerësi duhet t'i paguajë Shitësit për blerjen e gazit natyror gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate (çmimi i shitjes), është fiksuar sipas urdhrit nr. 83, datë 10.2.2012, "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure", i ndryshuar, dhe do të jetë ____ eur/MWh çmim njësi, i bazuar në çmimin ditor të gazit sipas platformës së çmimeve TTF (ICE INDEX DUTCH TTF GAS FUTURES).

5.2 Blerësi për çdo sasi gazi natyror që do t'i livrohet në përputhje me grafikun e livrimit, nga Shitësi, duhet të parapaguajë (në *cash*, me letër



kreditit ose nëpërmjet një instrumentit tjetër financiar të kërkuar nga Shitësi) shumë e detyrimit për këtë sasi, të llogaritur sipas çmimit për njësi të përcaktuar në nenin 5.1, më sipër.

5.3 Shitësi faturon Blerësin nëpërmjet një fature të detajuar për sasi të furnizuara të gazit natyror gjatë muajit të kaluar, sipas matjeve të kryera nëpërmjet pajisjeve matëse, në përputhje me parashikimet e nenit 3. Çdo faturë tatimore duhet të ketë bashkëngjitur origjinalin e faturës teknike të përpiluar dhe firmosur nga komisionet e Shitësit dhe Blerësit.

5.4 Detyrimet financiare, objekt i kësaj kontrate, do të paguhet nga Blerësi, në favor të Shitësit në llogarinë bankare të këtij të fundit

5.5 Në rast se Blerësi nuk i paguan detyrimet brenda afateve të përcaktuara në kontratë, atëherë Shitësi i lind e drejta të kërkojë kamatëvonesë, e cila do të llogaritet sipas ligjit për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

6.1 Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

i) Blerësi paraqet një sigurim kontrate, në masën 10% të vlerës totale të kontratës (përfshirë edhe TVSH-në), vlerë e cila përlllogaritet në bazë të sasive të parashikuara në grafikun vjetor të lëvrimin, për të garantuar Shitësin në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës. Garancia do të jetë në përputhje me kushtet dhe konform formatit që Shitësi do t'i vërë në dispozicion Blerësit.

ii) Blerësi garanton se ka siguruar të gjitha miratimet, lejet, autorizimet e nevojshme që e lejojnë të jetë palë e kësaj kontrate dhe të zbatojë detyrimet e përcaktuara në të gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

iii) Blerësi ka detyrimin të njoftojë menjëherë Shitësin për çdo fakt apo rrethanë, që mund të rrezikojë mospërmbushjen e detyrimeve të marra përsipër në këtë kontratë.

iv) Blerësi ka detyrimin të tërheq sasinë e gazit natyror në përputhje me grafikun e lëvrimin, brenda afatit të përcaktuar si dhe të kryejë pagesat përkatëse në favor të Shitësit.

6.2 Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

i) Shitësi ka detyrimin t'i shesë gaz natyror Blerësit sipas kushteve të rëna dakord në këtë

kontratë, duke respektuar specifikimet e parashikuara në nenin 4, si dhe t'i lëshojë Blerësit faturën tatimore përkatëse.

ii) Shitësi garanton se ka siguruar të gjitha miratimet, lejet, autorizimet e nevojshme që e lejojnë të jetë palë e kësaj kontrate dhe të zbatojë detyrimet e përcaktuara në të.

iii) Shitësi ka të drejtë ta zgjidh kontratën në çdo kohë në rast se Blerësi nuk likuidon plotësisht apo pjesërisht detyrimet ose në rast se Blerësi shkel kushtet e kontratës, duke respektuar parashikimet e nenit 10 të kësaj kontrate. Në rastin e zgjidhjes së njëanshme të kontratës, Shitësi ka të drejtë të konfiskojë shumë për sigurimin e kontratës

Neni 7

Pezullimi dhe dështimi i Shitësit në lëvrimin e sasisë së parashikuar

7.1 Shitësi duhet t'i dorëzojë Blerësit një plan duke specifikuar sasi të gazit natyror për muajin kalendarik pasardhës. Palët duhet të takohen në mënyrë periodike, sipas nevojave, për të përcaktuar dhe rregulluar sasi të gazit natyror të planifikuar paraprakisht nga Shitësi.

7.2 Shitja e gazit natyror në përputhje me këtë kontratë do të pezullohet nëse është e nevojshme dhe në masën që i duhet palëve për të qenë në përputhje me mirëmbajtjen e planifikuar dhe ndërprerjet e punës së rrjetit të gazsjellësit njoftuar nga operatori i gazsjellësit ose me ndërprerjet e punës së gazsjellësit si pasojë e shkaqeve teknike të paparashikuara, të cilat duhet të verifikohen në prani të dy palëve.

7.3 Në rastin e parashikuar në paragrafin 7.2 më sipër, Shitësi duhet të vazhdojë furnizimin e gazit natyror, në përputhje me këtë kontratë, menjëherë pasi kjo të bëhet teknikisht e mundur, pas një ndërprerje të planifikuar ose të detyruar.

7.4 Në rast se Shitësi nuk arrin të furnizojë Blerësin me sasinë totale vjetore të gazit natyror, Shitësi duhet t'i dërgojë një njoftim Blerësit ku të paraqesë shkaqet që justifikojnë pamundësinë e lëvrimin të sasisë vjetore të planifikuar. Palët kanë të drejtë që të negociojnë, në mënyrë që sasi të palëvruara për një vit, të plotësohen në vitin pasardhës, në rast se kjo është e mundur.



Neni 8

Forca madhore

8.1 Me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe këtu, kur një Palë nuk ka mundur të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj kontrate për shkak të forcës madhore, njofton dhe jep hollësi të plota me shkrim të një ngjarjeje të tillë të forcës madhore, te Pala tjetër dhe detyrimet e secilës Palë, mund të pezullohen gjate vazhdimit të kësaj ngjarjeje të forcës madhore.

8.2 Për qëllimet e këtij neni, “Forcë madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palëve, është e paparashikueshme, nuk ka ardhur si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të tyre ose nga neglizhenca e tyre dhe kanë bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve kontraktore pavarësisht të gjitha masave të ndërmarra nga pala, subjekt i kësaj ngjarjeje. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, embargo etj.

8.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e forcës madhore, palët duhet të njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën. Me përjashtim kur palët bien dakord ndryshe, ato duhet të vazhdojnë të zbatojnë detyrimet e tyre sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e tyre të arsyeshme për të minimizuar efektet e një ngjarjeje të tillë dhe për të kaluar një ngjarjeje të tillë sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur.

Neni 9

Negociatat dhe amendamentet

9.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Blerësit.

9.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t’i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Blerësit dhe Shitësit.

9.3 Çdo heqje dorë nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 10

Zgjidhja e kontratës

10.1 Shitësi mund të zgjidh kontratën, në rast se:

i) Blerësi dështon në tërheqjen e gazit natyror brenda periudhës së specifikuar në kontratë, pa ndonjë shkak ligjor dhe pa e njoftuar me shkrim Shitësin për vonesën; ose

ii) Blerësi shkelje në mënyrë të përsëritur pavarësisht njoftimit të Shitësit për përmbushjen e saj;

iii) Blerësi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë; ose

iv) Blerësi ka dështuar të likuidojë pjesërisht apo plotësisht detyrimet financiare ndaj Shitësit;

v) Gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t’i shërbyer sa më mirë interesit publik.

10.2 Në çdo rast, Shitësi duhet t’i japë Blerësit njoftim me shkrim 15 ditë përpara për zgjidhjen e kontratës për mospërmbushje të detyrimeve. Nëse detyrimi nuk është përmbushur pas kalimit të këtij afati, Shitësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

11.1 Shitësi dhe Blerësi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e lindura midis tyre në lidhje me këtë marrëveshje, me negociata direkte.

11.2 Në rast se palët dështojnë në zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ose konfliktit, secila palë ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për zgjidhjen e tyre.

Neni 12

Kushte të tjera

12.1 Të gjitha afatet e cituara në këtë kontratë janë kalendarike.

12.2 Çdo njoftim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi ose me postë në adresën e regjistruar të palëve dhe do të ketë efekt që nga dita e marrjes së tij nga pala tjetër.

12.3 Nëse pas hyrjes në fuqi të kontratës, ka ndryshime në legjislacion të tilla që mund ndryshojnë ndonjë nga kushtet e kontratës, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të



rregullohen në atë masë sa Blerësi të mos ndikohet në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

12.4 Çmimet e caktuara në këtë kontratë janë fikse dhe nuk ndryshojnë me bisedime gjatë kohës së ekzekutimit të kësaj kontrate.

12.5 Kontrata hartohet në 4 (katër) kopje, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

Kontrata e mësipërme, pasi u lexua, u kuptua, firmoset me vullnetin e lirë të palëve.

PALET

Për shitësin:

Për Blerësin:

VENDIM

Nr. 72, datë 7.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 45 Akti, që i përket:

KËRKUES: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar në gjykim nga z. Geldjon Hysolli dhe znj. Jonida Hoxha.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Rakip Suli, përfaqësuar në gjykim nga Av. Aranit Roshi.

1/10-ta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Ivi Kaso dhe z. Gazmend Bardhi.

OBJEKTI: Konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli.

BAZA LIGJORE: Nenet 70, paragrafët 3 dhe 4, dhe 78, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 66/3 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, pretendimet e përfaqësuesit të kërkuesit, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili e la në çmim të Gjykatës, prapësimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, deputetit Rakip Suli, i cili kërkoi rrezimin e kërkesës, pretendimet e përfaqësuesit të një të dhjetës së deputetëve të Kuvendit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013, të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, z. Rakip Suli është shpallur kandidat fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Tiranë.

2. Në datën 16.12.2015, një grup prej 20 deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ka depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) mocionin për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli. Nga aktet e bashkëlidhura rezulton se ky deputet ka qenë ortak në shoqërinë “Aurora Group” sh.p.k., kuotat e së cilës në datën 5.9.2013 ia ka transferuar djalin të tij Saimir Suli. Me kontratën e qirasë të datës 3.10.2014, OSSHE-ja, në cilësinë e qiramarrësit, ka lidhur me shoqërinë “Aurora Group” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit, një kontratë qiraje për një ambient për arkiv qendror në Tiranë, me afat 3-vjeçar dhe çmim të përcaktuar. Sipas grupit të deputetëve ndodhemi para shkëljes së neneve 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” (*ligji nr. 9367/2005*), të cilat zbatohen jo vetëm për funksionarin, por edhe për personat e lidhur me të, çka përbën ushtrim të mandatit të deputetit në cenim të papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 70/2 i Kushtetutës. Po ashtu, ata kanë pretenduar se personi i lidhur me deputetin Rakip Suli, konkretisht djali i tij madhor, ka përfutuar të ardhura nga buxheti i shtetit, të cilat në kuptim të nenit 35/2, të ligjit nr. 9367/2005, konsiderohen se janë fituar nga një shoqëri në pronësi të vetë deputetit, për rrjedhojë është cenuar edhe ndalimi kushtetues i nenit 70/3 të Kushtetutës.



3. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në mbledhjen e datës 1.3.2016, pasi ka zhvilluar procedurën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, ia ka kaluar atë seancës plenare për votim.

4. Me vendimin nr. 22/2016, datë 17.3.2016, Kuvendi ka vendosur: “Mosmiratimin e kërkesës së 20 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, me objekt: “Konstatimi i mbarimit të mandatit të deputetit Rakip Suli dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin e deputetit””.

5. Bazuar në interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, bërë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, 1/10-ta e deputetëve të Kuvendit, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kërkoi që Kuvendi t’ia dërgonte çështjen e mandatit të deputetit Rakip Suli Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi referuar edhe vetë kërkesës së këtij deputeti, me vendimin nr. 29/2016, datë 14.4.2016, vendosi: “Dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së mandatit të deputetit të zotit Rakip Suli.”

II

6. **Kuvendi**, në mbështetje të nenit 70/4 të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) duke i vënë në dispozicion vendimet nr. 22/2016 dhe nr. 29/2016, raportin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si edhe kërkesën e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, sipas të cilëve deputeti Rakip Suli ka ushtruar mandatin e deputetit në kundërshtim me nenin 70, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, për shkak se shoqëria ku ai ka qenë ortak, kuotat e së cilës më pas ia ka transferuar djalit të tij madhor, ka përfituar fonde publike. Kuvendi në parashtrimet e tij e ka lënë në çmim të Gjykatës zgjidhjen e çështjes.

7. **Subjekti i interesuar Rakip Suli** ka parashtruar sa më poshtë:

7.1 Me vendimin nr. 93, datë 17.5.2016, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar mungesën e juridiksionit në shqyrtimin e një çështjeje analoge (atë të deputetes Valentina Leska). Duke qenë se edhe në rastin konkret kërkesa e deputetëve të opozitës është e bazuar në të njëjtat shkaqe dhe argumente ligjore si në rastin e disponuar me vendimin e

mësipërm, Gjykata nuk duhet ta marrë në shqyrtim, pasi është ngritur për shkaqe që nuk janë të parashikuara nga ligjvënësi në Kushtetutë si raste për të cilat mund të investohet kjo Gjykatë.

7.2 Barazimi që i është bërë figurës së funksionit të deputetit me atë të çdo zyrtari të administratës shtetërore, për shkak të interpretimit të nenit 21 të ligjit nr. 9367/2005, nuk është i drejtë, sepse vetë Kushtetuta ka dy raste që çojnë në atë që quhet “papajtueshmëri e funksionit të deputetit” dhe konkretisht të parashikuara në pikën 2 të nenit 70.

7.3 Kalimi i kuotave që deputeti Rakip Suli zotëronte në shoqërinë “Aurora Grup” është bërë në datën 5.9.2013 me anë të kontratës së dhurimit. Në momentin e transferimit të kuotave të kësaj shoqërie në favor të djalit të tij (Saimir Suli), ky i fundit, në bazë të certifikatës së gjendjes civile, rezultoi i ndarë nga trangu i familjes që në vitin 2010. Po ashtu, kontrata e qirasë mes OSHEE-së dhe “Aurora Grup” sh.p.k., ku Saimir Suli është ortak në minorancë, është lidhur në datën 3.10.2014.

7.4 Në rastin konkret deputeti Rakip Suli nuk ndodhet para asnjë ndalimi nga ato të parashikuara në dispozitën e nenit 70 të Kushtetutës, për më shumë që kontrata është lidhur mes dy subjekteve private (OSHEE-ja ka qenë ortak me një aksioner mazhoritar privat).

7.5 Kontrata e kontestuar plotëson kushtet e nenit 35/4 të ligjit të posaçëm.

8. **Subjekti i interesuar, 1/10-ta e deputeteve të Kuvendit**, ka parashtruar si vijon:

8.1 Papajtueshmëritë sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe janë kompetencë e saj sipas shkronjës “e” të nenit 131 të Kushtetutës.

8.2 Nëse Gjykata Kushtetuese do të ishte kompetente për të vendosur vetëm për papajtueshmërinë e parashikuar nga neni 70/3 i Kushtetutës, kjo kompetencë i njihet nga neni 70/4 i Kushtetutës dhe nuk kishte arsye përse të përfshihej edhe në nenin 131/e. Formulimi i nenit 131/e është i përgjithshëm dhe u referohet të gjitha çështjeve që lidhen me papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit të deputetit.

8.3 Shoqëria “Aurora Group” sh.p.k., që është në pronësi të djalit të deputetit Rakip Suli, ka lidhur kontratë me një shoqëri publike, duke përfituar në këtë mënyrë fonde publike.



8.4 Legjislatori në parashikimet që ka bërë në nenet 21, 24, 35 dhe 45, të ligjit nr. 9367/2005, ka pasur si qëllim mundësimin e institutit të papajtueshmërisë të parashikuar në nenin 70 të Kushtetutës.

8.5 Në rastin konkret masa e marrë nga deputeti nëpërmjet kalimit të shoqërisë nga ai te djali, nuk ka arritur të shmangë përfitimin e fondeve publike, gjë që vjen në kundërshtim me ndalimet e parashikuara në nenin 70 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 9367/2005, që synojnë pikërisht eliminimin e situatave të konfliktit të interesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata Kushtetuese vlerëson se juridiksioni i saj në çështjen objekt shqyrtimi lidhet me përmbajtjen e nenit 70 të Kushtetutës.

10. Sipas paragrafit 3, të nenit 70 të Kushtetutës, deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre. Kurse sipas paragrafit 4 të tij: “Për çdo shkëlqje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë”. Në këtë dispozitë janë përcaktuar subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij), si dhe Kuvendi si subjekt i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues. Përmbajtja e nenit 70/4 të Kushtetutës reflektohet edhe në nenin 66/3 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatë nga Kuvendi për sa kohë vazhdon mandati i deputetit. Vendimmarrja e Kuvendit, në kuptim të nenit 70/4 të Kushtetutës, është në funksion të legjitimitetit të këtij subjekti për iniciimin e gjykimin kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (*shih vendimet nr. 29, datë 30.6.2011; nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga pikëpamja formale, në rastet e konstatimit të papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, është Kuvendi që vë në lëvizje Gjykatën, e cila është organi që shprehet për themelin e

çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur ndalimin kushtetues të nenit 70/3 të Kushtetutës.

12. Për sa i takon çështjes së juridiksionit të saj, që lidhet me papajtueshmërinë e mandatit të deputetëve, Gjykata ka theksuar se “*parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive që lidhen me mandatin e deputetit përbën një garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe evitimin e konflikteve të interesave. Ndërsa sipas paragrafit 2 të nenit 70 Kushtetuta jonë ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi të mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ai ka si anëtar i organit më të lartë përfaqësues[...]. Gjykata arrin në përfundimin se për çdo shkëlqje të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën ta shqyrtojë në themel çështjen. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kritereve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi.” (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).*

13. Gjykata vëren se në rastin konkret është kërkuar konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, duke iu referuar paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 24 të ligjit nr. 9367/2005, për shkak se shoqëria ku është ortak shtetasi Saimir Suli (djali i madh i deputetit Rakip Suli), kuotat e të cilit më parë ishin në pronësi të këtij deputeti, ka përfituar të ardhura që burojnë nga fondet publike si pasojë e lidhjes së një kontrate qiraje me një shoqëri me kapital 100% shtetëror, siç është OSSHE-ja.

14. Sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës, rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj, kurse sipas nenit 21/1 të ligjit nr. 9367/2005: “*Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së*



shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”. Sipas paragrafit 1, të nenit 24, të këtij ligji, persona të lidhur me zyrtarin konsiderohen edhe fëmijët në moshë madhore të tij, kurse sipas paragrafit 3 të po këtij neni ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të.

15. Bazuar në paragrafin 4, të nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të paragrafit 3, të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 4 të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës apo ligjeve të cilat ai referon, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre.

16. Sipas subjektit të interesuar, 1/10-ës së deputetëve, çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë me mandatin e deputetit, Kushtetuta i ka parashikuar në kompetencat që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 131/e të Kushtetutës.

17. Gjykata e vlerëson këtë pretendim si të pambështetur. Pika 2 e nenit 70 të Kushtetutës përbën një rregullim specifik dhe bazuar në rregullin interpretues, sipas të cilit norma specifike ka përparësi mbi normën e përgjithshme, *lex specialis derogat lex generalis* (shih vendimin nr. 2/2010 të Gjykatës Kushtetuese), kjo dispozitë ka përparësi mbi nenin 131/e, i cili përmban një rregullim të përgjithshëm ku listohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese.

18. Në konkluzion, Gjykata vlerëson se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatin të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastet e parashikuara nga

neni 70/3 i Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucionin i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet për vënien e saj në lëvizje në kuptim të përmbajtjes së nenit 70/4 të Kushtetutës dhe çështja në fjalë e paraqitur nga Kuvendi nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 70, 70/4 dhe 131/e të Kushtetutës, si dhe të neneve 66/3, 67/2, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,¹

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkesë Rakip Sulin ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, por nuk pajtohem me linjën e arsyetimit të bërë prej saj në lidhje me themelin e çështjes. Për këtë arsye e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim paralel.

2. Bazuar në interpretimin e pikës 4, të nenit 70 të Kushtetutës, bërë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, Kuvendi, referuar edhe vetë kërkesës së deputetit Rakip Suli, me vendimin nr. 29/2016, datë 14.4.2016, vendosi: “Dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së mandatin të deputetit të zotit Rakip Suli”. Mendoj

¹ Gjyqtari Sokol Berberi është shprehur pro vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, por me mendim paralel.



se Kuvendi nëpërmjet këtij vendimi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 70/4 të Kushtetutës. Qëndrimi im në lidhje me këtë çështje mbështetet në dy argumente kryesore, të cilat i kam theksuar edhe në mendimin e pakicës të vendimit nr. 32/2016 të Gjykatës Kushtetuese.

3. *Së pari*, Kuvendi, nëpërmjet vendimit nr. 29/2016, nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës për kërkesën objekt shqyrtimi në kushtet kur nuk ka një vendimmarrje të Kuvendit, sipas kuptimit që i është dhënë nenit 70/4 të Kushtetutës në mendimin e pakicës të vendimit nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mendim pakice jam shprehur se “kuptimi i pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës është ky: Kuvendi vihet në lëvizje për shkelje të pikës 3 të nenit 70; Kuvendi vihet në lëvizje nga Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij; Kuvendi vendos për shkeljen e pikës 3 të nenit 70 dhe, për rrjedhojë, dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese; Gjykata Kushtetuese konstaton papajtueshmërinë. Kuvendi nuk ka rol formal dhe nuk është i detyruar ta dërgojë në çdo rast për shqyrtim çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Vendimi i Kuvendit, që ka verifikuar shkeljen e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës nga ana e deputetit, ndaj të cilit është kërkuar procedimi, detyrimisht i dërgohet Gjykatës Kushtetuese”. Kuvendi duhet të marrë vendim fillimisht për verifikimin e shkeljes dhe më pas çështja i dërgohet Gjykatës Kushtetuese. Në rastin konkret nuk ka një vendimmarrje të Kuvendit, sipas kuptimit të mësipërm të nenit 70/4 të Kushtetutës, ndaj çmoj se Kuvendi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me anë të kësaj kërkesë.

4. *Së dyti*, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në mendimin e pakicës të vendimit nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese, vlerësoj se Gjykata, si rregull, është një organ që ka funksion rishikues, si dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 124 i Kushtetutës). Ajo nuk bën vlerësimin fillestar të çështjes në themel, por kontrollon, në aspektin kushtetues, vendimmarrjen e institucioneve kushtetuese, pasi këto janë shprehur. Në këtë kuptim, edhe në rastin e procedurës për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, ajo rishikon vendimmarrjen e Kuvendit, sipas pikës 4, të nenit 70 të Kushtetutës, pasi Kuvendi, i cili nuk ka një rol krejtësisht formal,

ka marrë vendimin t’ia dërgojë çështjen për konstatimin e papajtueshmërisë.

5. Ky përfundim është në harmoni me jurisprudencën e Gjykatës, përkatësisht me vendimet nr. 29, datë 30.6.2011 dhe nr. 44, datë 7.10.2011 të saj, nga leximi i të cilave vërehet se: “[...] bazuar në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës, konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit është në kompetencën e kësaj Gjykate. Kjo normë ka përcaktuar Kuvendin si subjekt të posaçëm që vë në lëvizje këtë gjykim kushtetues, si dhe subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim (Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij) (§ 18 i vendimit nr. 29, datë 30.6.2011; § 9 i vendimit nr. 44, datë 7.10.2011). Në asnjërin prej këtyre vendimeve nuk është theksuar tekstualisht se Gjykata është organi i vetëm që vendos për themelin e çështjes, pra nëse veprimet konkrete të një anëtari të Kuvendit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Kushtetutëbërësi ka parashikuar dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të vendimit të Kuvendit, që ka verifikuar shkeljen e pikës 3, të nenit 70 të Kushtetutës, në mënyrë që Gjykata, e cila ka funksion rishikues, të konstatojë më pas shkeljen.

6. Si përfundim mendoj se kërkuesi në rastin konkret nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Kuvendi i Shqipërisë, me objekt konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli, nuk jam dakord me vendimin e shumicës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Për rrjedhojë, në vijim paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. Sipas shumicës “bazuar në paragrafin 4, të nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka juridiksionin për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të paragrafit 3, të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të



Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 4, të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës apo ligjeve të cilat ai referon, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre. Pika 2, e nenit 70, të Kushtetutës përbën një rregullim specifik dhe bazuar në rregullin interpretues, sipas të cilit norma specifike ka përparësi mbi normën e përgjithshme, lex specialis derogat lex generalis, kjo dispozitë ka përparësi mbi nenin 131/e, i cili përmban një rregullim të përgjithshëm ku listohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Në konkluzion, Gjykata vlerëson se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70/3 i Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucioni i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit” (shih paragrafët 15–18 të vendimit).

3. Bazuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 70 të Kushtetutës për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë. Sipas kësaj dispozite subjektet që iniciojnë procedurat parlamentare për këtë qëllim janë Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij, kurse Kuvendi është subjekti i posaçëm që vë në lëvizje gjykimin kushtetues. Në rastet e shkeljes së paragrafit 3, të nenit 70 Gjykata ka theksuar se Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën ta shqyrtojë në themel çështjen. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me verifikimin e kriterëve juridiko-formale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në rregulloren e këtij organi (shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

4. Megjithatë, këto dispozita nuk mund të interpretohen se kufizojnë juridiksionin e Gjykatës për rastet e shkeljes së paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës, pra për rastet e papajtueshmërive të tjera të përcaktuara me ligj. Edhe pse sipas këtij paragrafi Kushtetuta ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, kurse në pikën 3 të këtij neni e ka vendosur ndalimin në rang kushtetues, këto parashikime nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me juridiksionin e Gjykatës. Ndërkohë që në rastin konkret Gjykata duhet të

lexojë dhe të interpretojë dispozitat kushtetuese që përcaktojnë juridiksionin e saj jo në mënyrë të shkëputur, që do të thotë se neni 70 i Kushtetutës duhet të lexohet së bashku me nenin 131 të saj.

5. Sipas shkronjës “e”, të nenit 131 të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese vendos për “çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre...”. Ndërkohë që dispozita e mësipërme është materiale, neni 70/4 i Kushtetutës është një dispozitë me karakter procedural, që ka si qëllim të përcaktojë një rregullim të ndryshëm për mënyrën e vënies në lëvizje të kësaj Gjykate në rastet e shkeljes së paragrafit 3. Kjo dispozitë procedurale në vlerësimin tim nuk mund të interpretohet se përcakton nga pikëpamja materiale edhe objektin e kontrollit kushtetues, pra duke lënë jashtë rastet e papajtueshmërisë sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës.

6. Nëse do të bënim një interpretim të ndryshëm, pra se Gjykata ka kompetencë të shqyrtojë vetëm rastet e papajtueshmërisë sipas paragrafit 3, të nenit 70, atëherë rastet e papajtueshmërisë të parashikuara në paragrafin 2 të po këtij neni do të mbeteshin jashtë kontrollit, për sa kohë që nuk ka një parashikim tjetër specifik në lidhje me to. Në rastin konkret vlerësoj se kushtetutëbërësi nuk ka ometuar duke mos bërë një parashikim të ndryshëm të rasteve të papajtueshmërisë sipas paragrafit 2, të nenit 70, por ka pasur si qëllim të veçojë procedurën në rastet e shkeljeve të paragrafit 3 për të mënjeluar diskrecionin e organeve të përfshira në këtë procedurë, duke përcaktuar detyrimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese në çdo rast.

7. Për sa më sipër, në kuptim të neneve 131 dhe 70 të Kushtetutës, vlerësoj se Gjykata ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkeljet e paragrafëve 2 dhe 3, të nenit 70 të Kushtetutës, për rrjedhojë ajo duhet ta shqyrtonte në themel çështjen.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. 1/10-a e deputetëve të Kuvendit, anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ka depozituar në Kuvend mocionin për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip



Suli. Ata pretendojnë se janë shkelur nenet 21 dhe 24, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” (ligji nr. 9367/2005), të cilat zbatohen jo vetëm për funksionarin, por edhe për personat e lidhur me të, çka përbën ushtrim të mandatit të deputetit në kushtet e papajtueshmërisë të parashikuar nga neni 70/2 i Kushtetutës. Po ashtu, ata kanë parashtruar se personi i lidhur me deputetin Rakip Suli, konkretisht djali i tij madhor, ka përfutur të ardhura nga buxheti i shtetit, të cilat në kuptim të nenit 35/2, të ligjit nr. 9367/2005, konsiderohen se janë fituar nga një shoqëri në pronësi të vetë deputetit, për rrjedhojë është cenuar edhe ndalimi kushtetues i nenit 70/3 të Kushtetutës.

2. Kuvendi ka vendosur mosmiratimin e kërkesës së 1/10-s së deputetëve, të cilët, bazuar në interpretimin e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, bërë nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 7, datë 24.2.2016, kanë kërkuar që Kuvendi t’ia dërgonte çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi, referuar edhe vetë kërkesës së këtij deputeti, me vendimin nr. 29/2016, datë 14.4.2016, ka vendosur: “Dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes së mandatit të deputetit të zotit Rakip Suli”.

3. Shumica, pasi ka çmuar se në rastin konkret është kërkuar konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, duke iu referuar paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 24, të ligjit nr. 9367/2005 (*shih paragrafin nr. 13 të vendimit të shumicës*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas shumicës, bazuar në paragrafin 4, të nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka juridiksion vetëm për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të paragrafit 3, të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutëbërësi ka parashikuar vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 4, të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi që ka kompetencën për të shqyrtuar në themel çështjen. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës apo

ligjeve të cilat ai referon, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre (*shih paragrafin nr. 15 të vendimit të shumicës*).

4. Gjithashtu, shumica ka arritur në përfundimin se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70/3 i Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucionin i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit (*shih paragrafin nr. 18 të vendimit të shumicës*).

5. Në vlerësimin tonë një trajtim i tillë sipërfaqësor i problemit më thelbësor në këtë çështje, duke u kufizuar thjesht në interpretimin e nenit 70/3 të Kushtetutës, lë jashtë vëmendjes dispozitat e tjera kushtetuese dhe ligjore të lidhura me çështjen në shqyrtim për efekt të juridiksionit të kësaj Gjykate lidhur me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të deputetit. Për shkak të diferencave parimore me shumicën në këtë çështje, e shohim me vend të shprehemi me mendim pakice.

6. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parashikimi nga kushtetutëbërësi i rasteve të papajtueshmërive që lidhen me mandatin e deputetit përbën një garanci për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë në ushtrimin e mandatit parlamentar, si dhe evitimin e konflikteve të interesave. Ndërsa sipas pikës 2, të nenit 70 Kushtetuta jonë ua ka deleguar ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë, në pikën 3 të kësaj dispozite ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutëbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të shkaqeve për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi e mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ka ai si anëtar i organit më të lartë përfaqësues (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se ajo është organi i vetëm që ka kompetencën të vendosë nëse veprimet konkrete të një anëtarit të Kuvendit, kundër të cilit është iniciuar procedura për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin,



janë në kundërshtim me Kushtetutën. Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimi nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse në të kundërt do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës Kushtetuese. Me fjalë të tjera, ndonëse verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, vlerësimi i meritës së çështjes, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimin nr. 7, datë 24.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata, gjithashtu, ka vlerësuar se pavarësisht se vihet në lëvizje në bazë të nenit 70/3 të Kushtetutës, kjo dispozitë nuk mund të lexohet e shkëputur nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, i cili edhe pse në thelb ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, për sa u takon rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit, referon te ligji nr. 9367/2005, sipas të cilit: “*Deputeti: a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme...*” (neni 28). Përveç ndalimeve të sipërcituara, ky ligj ka parashikuar edhe mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit. Gjykata thekson se ndonëse nuk i takon asaj të përcaktojë apo të orientojë se cilat janë masat apo veprimet konkrete që duhet të ndërmerren nga deputetët përpara marrjes së detyrës, me qëllim shmangien e situatave të papajtueshmërisë në të ardhmen, ajo e sheh me vend të theksojë se është detyrë e këtyre të fundit, që në përputhje me të gjithë kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi, të marrin masat e duhura për të plotësuar detyrimet që rrjedhin me rastin e marrjes së mandatit parlamentar (*shih vendimin nr. 32, datë 3.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Bazuar në këtë jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese mendojmë se shqyrtimi i problemit të juridiksionit të Gjykatës për çështjet që lidhen me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit sipas nenit 70/2 dhe 70/3 të Kushtetutës, duhet bërë në

funksion të analizës në tërësi të dispozitave që kanë lidhje me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Konkretisht, neni 131/e i Kushtetutës çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë me mandatin e deputetit i ka parashikuar në kompetencat që i janë dhënë Gjykatës Kushtetuese pa bërë asnjë dallim apo përjashtim. Duke shkuar më tej, edhe neni 71/2/c i Kushtetutës, që trajton rastet e mbarimit apo të pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, referon në rastet e papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 70/2 dhe 70/3, pa bërë asnjë dallim midis tyre.

10. Në mbështetje të kësaj fryme të Kushtetutës të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe ligjvënësi në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit të bëra me ligjin nr. 99/2016). Kështu, në nenin 66/3 të tij lidhur me përcaktimin e procedurës për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit të deputetit nga ana e kësaj Gjykate, thuhet shprehimisht se kërkesa për papajtueshmëri mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese nga Kuvendi për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, pa bërë ndonjë dallim në llojin e papajtueshmërisë.

11. Nëse *ad absurdum* do të pranohej përfundimi i shumicës se me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 70/3 të Kushtetutës, për të gjitha rastet e tjera është Kuvendi institucioni i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit, ky i fundit në rregulloren e tij do të kishte parashikuar edhe procedurat përkatëse që duheshin ndjekur (sikurse ka vepruar për të gjitha rastet e tjera në kompetencë të tij). Përkundrazi, në rregulloren e Kuvendit nuk gjendet asnjë dispozitë lidhur me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Vetëm në nenin 13 të saj ka disa rregulla të përgjithshme që trajtojnë kompetencat e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

12. Për më tepër, jemi të mendimit se ky ometim (nëse do të konsiderohej i tillë) i rregullores së Kuvendit nuk plotësohet as nga Kodi Zgjedhor. Në nenin 164 të tij Kodi Zgjedhor trajton vetëm procedurën për ndërprerjen e mandatit të deputetit dhe zëvendësimin e vakancës, duke ju referuar nenit 71 të Kushtetutës. Ndërkohë, asnjë dispozitë tjetër e Kodit nuk shprehet për këtë çështje.

13. Edhe nga një vështrim i përgjithshëm krahasimor me disa nga vendet evropiane, por



edhe më gjerë evidentohet se ekzistojnë dy modele kryesore. Në disa vende (Austria, Portugalia, Republika Çeke, Italia, Franca dhe Holanda) është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese shqyrtimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Në këto vende Gjykata kontrollon papajtueshmërinë bazuar në Kushtetutë dhe ligje të veçanta. Nisur edhe nga fakti se karakteristika kryesore e normave kushtetuese është karakteri i tyre abstrakt dhe përgjithësues, rastet konkrete të papajtueshmërisë parashikohen me ligj. Ndërsa në modelin e dytë përfshihen ato vende (Spanja, Sllovenia, Luksemburgu, Kroacia, Gjermania, Moldavia dhe Rumania) në të cilat Gjykata nuk ka kompetenca për shqyrtimin e rasteve të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit dhe organi kompetent për të vendosur mbi mandatin e deputeti zakonisht është një komision i posaçëm brenda organit legjislativ, Parlamentit. Vendi ynë ka zgjedhur t'i bashkohet grupit të parë.

14. Si përfundim, mendojmë se çështjet që lidhen me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit të deputetit, pavarësisht nga lloji i papajtueshmërisë, janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. Nëse qëllimi i kushtetutëbërësit do të ishte që kompetenca e kësaj Gjykate të kufizohej vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70/3, sikurse arsyeton shumica, organi kompetent për shqyrtimin e rasteve të tjera duhet të ishte gjithashtu i parashikuar nga Kushtetuta ose nga ligje të tjera të cilave ajo do t'ua delegonte. Përdërisa nuk ekziston asnjë dispozitë tjetër kushtetuese (përveç nenit 131/e që kompetencën ia ka dhënë Gjykatës Kushtetuese) dhe/ose ligjore që t'i njohë ndonjë organi tjetër këtë kompetencë, mendojmë se vendimmarrja e shumicës i bie ndesh vullnetit të kushtetutëbërësit.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vitore Tusha , Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 181, datë 23.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 104, DATË 23.6.2016, TË BORDIT TË ERE-s, “MBI PËRCAKTIMIN E METODOLOGJISË SË VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME, SI DHE MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË ERE-s NR. 49, DATË 21.10.2004 DHE NR. 146, DATË 24.12.2013”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, me nr. 96, datë 17. 6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23/11/2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarritshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013,

konstatoi:

- Bazuar në nenet 16 dhe 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 44/2015, rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s ka miratuar vendimin nr. 104, datë 23.6.2016,

- Në shkresën me nr. 800 prot., datë 14.10.2016, drejtuar kompanisë “OSHEE” sh.a., ERE ka parashtruar problematikat e disa klientëve të energjisë elektrike lidhur me faturimin nën zërin “konsum aktiv vlerë referuese” për muajin gusht 2016.

- Shoqëria “OSHEE” sh.a. me shkresën nr. 24869 prot., datë 27.10.2016, protokolluar me tonën me nr. 495/1 prot., datë 28.10.2016 ka paraqitur në ERE një kërkesë për interpretim.



- ERE ka organizuar një seancë dëgjimore më datë 14.11.2016, mes përfaqësuesve të shoqërisë “OSHEE” sh.a. dhe ERE me qëllim interpretimin e vendimit nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016 “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

- Nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a. janë bërë me dije një sërë problematikash lidhur me zbatueshmërinë nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a., të vendimit nr. 104 të Bordit të ERE-s, datë 23.6.2016, për kontratat e furnizimit të energjisë elektrike që nuk kanë një historik faturimi, për konsumin me matje të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në vendimin nr. 104, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi përcaktimin e metodologjisë së vlerave referuese në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme dhe të paarrtshme, si dhe mbi shfuqizimin e vendimeve të ERE-s nr. 49, datë 21.10.2004, dhe nr. 146, datë 24.12.2013”.

2. Pika 2 e vendimit nr. 104, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshohet si vijon:

a) “Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë së një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesit në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përlllogaritet bazuar në mesataren aritmetike të faturimeve me matje përgjatë 3 viteve të mëparshme, të të njëjtit muaj me atë të faturuar.

Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.”

b) “Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

c) Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me matës të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.”

ç) “Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. dhe palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 182, datë 23.11.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMEVE PËR SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË TE KLIENTËT QË FURNIZOHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, germa “b”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neneve 19, pika 1, germa “a” dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi



shqyrtoi relacionin e “draftmetodologjisë së Përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e “draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë te klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal” (bashkëlidhur drafti).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 183, datë 23.11.2016

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 7, 9 dhe nenit 10 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k. nëpërmjet “Kontratë kredie bankare”, me nr. 2324 rep. dhe nr. 1300 kol., datë 20.6.2016, ka lënë peng disa nga asetet e saj pranë “Raiffeissen Bank”;

- Nëpërmjet “Deklaratë noteriale” me nr. 4176 Rep., nr. 2387 kol., datë 22.9.2016 dhe nr. 4175 rep., nr. 2386 kol., datë 22.9.2016, “Raiffeissen Bank” sh.a., heq dorë nga pengi i vendosur në “Kontratën e Kredisë Bankare” të mësipërme;

- Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k. ka aplikuar pranë ERE-s për të miratuar lënien peng të aseteve pranë Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.;

- Aplikimi i Shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

Neni 7, pika 1, geramat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licencuar); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit); “j” (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënie peng të asetëve sipas listës bashkëlidhur, në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

LISTA PËR LËNIEN PENG TË ASETËVE TË SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 183, DATË 23.11.2016, TË BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERJISË (ERE)

HEC “Bele 1”, me fuqi 5000 KW:

1. Turbinë Frensis copë 2,
2. Gjenerator sinkron copë 2,
3. Valvol butterfly copë 2,
4. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
5. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
6. Transformator fuqie copë 2,
7. Qark 20 kV copë 2,
8. Qark 6 kV copë 2,
9. Qark automatizimi copë 2,
10. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
11. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
12. Tubacione 1813 m.

HEC “Topojan 2”, me fuqi 4800 KW

1. Turbinë Pelton copë 2,
2. Gjenerator sinkron copë 2,
3. Valvol butterfly copë 2,
4. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
5. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
6. Transformator fuqie copë 2,
7. Qark 20 kV copë 2,
8. Qark 6 kV copë 2,
9. Qark automatizimi copë 2,
10. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
11. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
12. Tubacione 2985 m.

N/st 20/110 kV

1. Transformator tensioni copë 2,
2. Konservues vaji copë 2,
3. Radiatorë me komponentët copë 2,
4. Depozita vaji copë 2,
5. Panele për transformatorët copë 2,
6. Mbrojtës mbtensionit copë 2,

7. Sisteme shtesë tap chenger copë 2,
8. Sewt shtesë compass për transformatorë copë 2,
9. Sisteme tokëzimi disconnecter copë 2.

VENDIM

Nr. 184, datë 23.11.2016

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LËNIEN PENG TË ASETËVE TË SHOQËRISË “ENERGAL” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të nenit 7; nenit 9 dhe nenit 10 të rregullores “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kërkesës së Shoqërisë “Energal” sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut; konstatoi se:

- Shoqëria “Energal” sh.p.k. nëpërmjet “Kontratë kredie bankare”, nr. 2337 rep. dhe nr. 1313 kol., datë 20.6.2016, ka lënë peng disa nga asetet e saj pranë “Raiffeissen Bank”;

- Nëpërmjet “Deklaratë noteriale” me nr. 4174 rep., nr. 2385 kol., datë 22.9.2016 dhe nr. 4177 rep., nr. 2388 kol., datë 22.9.2016, “Raiffeissen Bank” sh.a., heq dorë nga pengi i vendosur në “Kontratën e kredisë bankare” të mësipërme;

- Shoqëria “Energal” sh.p.k. ka aplikuar pranë ERE-s për të miratuar lënie peng të asetëve pranë Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.;

- Aplikimi i shoqërisë “Energal” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit” si më poshtë:

Neni 7, pika 1, gërmat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të



transferimit të aseteve); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licencuar); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit); “j” (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Energal” sh.p.k., për lënie peng të aseteve sipas listës bashkëlidhur në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohe brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

LISTA PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË “ENERGAL” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA
MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 184, DATË 23.11.2016 TË BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË (ERE)

HEC “Orgjost i ri” me fuqi 4800 KW

1. Gjenerator sinkron copë 2,
2. Valvol butterfly copë 2,
3. Bazament për gjenerator sinkron copë 2,
4. Sistem hidraulik dhe lubrifikues fuqie copë 2,
5. Transformator fuqie copë 2,
6. Qark 20 kV copë 2, Qark 6 kV copë 2,
7. Qark automatizimi copë 2,

8. Sisteme tub & komponent dhe sensor copë 2,
9. Sisteme lubrifikimi fillestar copë 2,
10. Tubacione 623 m.

N/st 20/110 kV

1. Transformator tensioni copë 2,
2. Konservues vaji copë 2,
3. Radiatorë me komponentët copë 2,
4. Depozita vaji copë 2,
5. Panele për transformatorët copë 2,
6. Mbrojtës mbitensionit copë 2,
7. Sisteme shtesë tap chenger copë 2,
8. Sewt shtesë mpass për transformatorë copë 2,
9. Sisteme tokëzimi disconnecter copë 2.

VENDIM

Nr. 185, datë 23.11.2016

MBI KËRKESËN E TAP AG PËR APROVIMIN E “PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË RREGULLATORE/REGULATORY COMPLIANCE PROGRAMME” TË RISHIKUAR, PARAQITUR NË BAZË TË OPINIONIT TË PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR /FINAL JOINT OPINION, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 12, DATË 14.2.2014

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, në zbatim të direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (direktiva 73/09); Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; vendimit të Komisionit Evropian C (2013) 2949 të datës 16 maj 2013; “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtimin (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin Itali (AEEGSI), Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim Final Joint Opinion; vendimit të Bordit nr. 12, datë 14.2.2014 “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion, në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP; kërkesës së TAP AG të datës 17 nëntor 2016, me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përputhshmërisë



Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” të rishikuar,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 12, datë 14.2.2014, ka miratuar Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP.

- TAP AG ka dërguar në ERE në datën 17 nëntor 2016, shkresën me numër reference të TAP LT-TAP-ERE-00018, për miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme të rishikuar, si detyrim i seksioneve 4.5.1 dhe 4.5.2 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion (FJO).

- Drafti i rishikuar, i dorëzuar nga shoqëria TAP AG është diskutuar mes të tre rregullatorëve, AEEGSI, ERE dhe RAE, të cilët kanë rënë dakord për draftin final të Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme të rishikuar (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë TAP AG, Rregullatorin Italian (AEEGSI), Rregullatorin Grek (RAE) dhe MEI, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 186, datë 23.11.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SPATHARË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1038 KW

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, germa “d”, nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 21 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a” dhe neni 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

- Në bazë të nenit 8 të Marrëveshjes Konçesionare datë 2.5.2013, në cilësinë e Konçesionarit së bashku shoqëria “Luçente” sh.p.k. dhe shoqëria “Loshi BL” sh.p.k. duhet që brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes të krijojnë shoqërinë konçesionare dhe të bëjnë regjistrimet e nevojshme për të lejuar këtë shoqëri të zhvillojë veprimtarinë e saj.

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” e cila ka aplikuar për t’u licencuar në ERE. nuk rezultoi të jetë krijuar nga bashkimi i dy shoqërive konçesionare “Luçente” sh.p.k. dhe “Loshi BL” sh.p.k.

- Nga aplikimi i shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k, rezultoi edhe mungesa e dokumentacionit si më poshtë:



- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.);

- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC-in);

- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin);

- Në korrespondencë zyrtare me ERE-n, shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e prodhimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Spatharë”, me fuqi të instaluar 1038 KW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 187, datë 23.11.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, 21 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, neni 4, pika 1, germa “g”; neni 5, pika 2; neni 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Nga aplikimi i shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., rezulton mungesa e dokumentacionit si më poshtë:

- Neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.);

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar); germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti) dhe germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur);

- Në korrespondencë zyrtare me ERE-n, shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar;

- Shoqëria “Luçente Konçesionare” sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e tregtimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Luçente Konçesionare” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Nr. 2015, datë 22.11.2016

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2015, datë 22.11.2016, vendosi shpalljen të vdekur në datën 17.8.1994 të shtetases Valbona Azem Harizaj e datëlindjes 23.1.1973.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë